

Derisa Lidhja Demokratike e Kosovës nuk po “dorëzohet” për të shkuar në një koalicion me Partinë Demokratike të Kosovës, është partia e Ramush Haradinajt – AAK, e cila gjithnjë e më shumë po i afrohet Hashim Thaçit.

Burimet e gazetës “Zëri” kanë konfirmuar se gjatë gjithë ditës së martë janë zhvilluar takime “tinëz” ndërmjet zyrtarëve të PDK-së dhe atyre të AAK-së për t’ia lidhur kryet një koalicioni qeveritar.

Mirëpo në këtë drejtim thuhet se nuk ka munguar “shigjetimi” as në drejtim të LDK-së, edhe pse kjo e fundit duket më e vendosur për t’i qëndruar deri në fund sloganit “Anti-Hashim”.
/Zëri/